

V E N D I M
Nr.398, datë 13.6.2003

PËR HEQJEN E LICENCAVE NË INDUSTRIJË JOSHQIMORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personat fizikë e juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj të deklarojnë në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës veprimtarinë prodhuese, që ushtrojnë në fushën e industrisë joshqimore në degët e mëposhtme:

- a) metalurgji mekanike;
- b) lëkurë-këpucë;
- c) tekstil-konfeksione;
- ç) gomë-plastikë;
- d) qelq-qeramikë;
- dh) dru-letër;
- e) kimikate të tjera.

2. Personat fizikë e juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, së bashku me deklarin, të paraqesin në Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës edhe këto dokumente:

- a) vendimin e regjistrimit në gjykatë si person fizik a juridik;
- b) certifikatën e regjistrimit në organet tatimore;
- c) planbiznesin.

3. Subjektet, që do të ushtrojnë veprimtari prodhuese në fushën e industrisë joshqimore, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, duhet të bëjnë deklarin brenda 3 muajve nga fillimi i ushtrimit të kësaj veprimtarie.

4. Vendimi nr.154, datë 7.4.2000 i Këshillit të Ministrave “Për licencimin e veprimtarive prodhuese në industrinë joshqimore”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano